



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.475/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rafet Haxhaj dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjore Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, Nusret Çubreli, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.10.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** si e pa rregullt ankesa e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, Nusret Çubreli, me shenjen ZL.Anr.475/2017 .

### A r s y e t i m

Më datën 23.10.2017, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Nusret Çubreli kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, me të cilën ankesë thekson se në shkollën “Skënderbeu” në Mitrovicë në Qendrat e Votimit 1105/b, komisioneri Shaban Idrizi, në QV1117/B komisioneri Shemsi Ahmeti, QV1103/B komisioneri Fazli Grajqevci dhe në QV 1112/b KOMISIONERI Bislim Imeri, duke mos e arsyetuar parashtrimet e pretendimeve ankimore.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë.

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të rregullësisë së ankesës gjeti se:

#### **Ankesa është e pa rregullt**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e parashtruar nga ana e kandidatit për anëtar të Kuvendit Komunal në Mitrovicë, Nusret Çubreli,, është e parregullt sepse e nejta ankesë nuk i plotëson standartet. Prandaj si e tillë ankesa nuk i plotëson kushtet që kërkohen me nenin 5.6 të Rregullës nr.02/2015 të PZAP-it dhe në bazë të nenit 118 të LZP-së ku përcaktohet se: *Ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe duhet të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari.*

Prandaj PZAP-i, nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuar nga dispozita e lartëtheksuara.

Nga arsyet e sipërshënuar e në mbeshtejte të nenit 6.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.475/2017 më datën 24.10.2017.



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.